

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Biljana Rexhiq, kryetare e kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Gani Zabeli, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve K.B. dhe D.B., që të dy nga fshati ... Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale lëndim i letë trupor si bashkëkryes nga eni 188 par.1 lidhur me par.2 dhe lidhur me neni n 31 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së të dëmtuarit S.E., të ushtruar kundër aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.321/2016 të dt. 15.05.2018, në seancë ne kolegjit të mbajtur me 06.08.2018 mori këtë :

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të dëmtuarit S.E., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.321/2016, të dt.15.08.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prizren-dega në Suharekë, P.nr.321/2016, të dt.15.05.2018, të akuzuarit K.B. dhe D.B., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor si bashkë kryes nga neni 188 par.1 lidhur me par.2 dhe lidhur me nenin 31, dhe secilit prej tyre i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në afat prej nga 4 (katër) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet poqë se secili i akuzuar në afatin e verifikimit prej nga 1(një) viti nuk kryen vepër te re penale.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Janë obliguar të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale ,dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20 euro- solidarisht, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej nga 30 euro secili veç e veç, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 euro secili veç e veç në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i dëmtuari S.E., për shkak të vendimit lidhur me sanksionit penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i ashpër.

Përgjigje në ankesë të dëmtuarit ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit K.B., av.N.B., dhe ka propozuar që ankesa e të dëmtuarit të hudhet si e pa lejueshme, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.744/2018, të datës 19.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, kurse të akuzuarve tu shqiptohet dënimi me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e të dëmtuarit S.E., nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të dëmtuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, por i ka vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese sikurse janë se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë përkitazi me veprën penale e cila iu vihet në barrë, se kanë pasur sjellje korrekte gjatë gjithë procedurës penale, se janë penduar për kryerjen e së njëjtës, andaj nuk i ka vlerësuar në masë të duhur edhe rrethana rënduese, sepse në këtë çështje penale jemi të mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarve nuk është adekuat përgjegjësisë penale juridike të të njëjtëve dhe se me dënimet e shqiptuara nuk mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave e të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se kanë patur sjellje korrekte në gjykatë, se janë penduar për veprën e kryer penale, gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, si dhe ankesën e ushtruar, nga e cila nuk rezulton se është paraqitur ndonjë rrethane posaçërisht rënduese sikurse pretendon i dëmtuari S.E. andaj në prani të këtyre rrethanave, kolegji i kësaj gjykatë është i bindur se me dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë

me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.738/2018, të datës 06.08.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Përparim Zeka**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Biljana Rexhiq**

**Gani Zabeli**